

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, më datën 09.11.2020 (dymijë e njëzetë) lidhet kjo Kontratë midis palëve për shitblerjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë:

SHITËSI:

- **znj. Martina Lorenzotto**, e datëlindjes 25.05.1979, lindur në Piove Di Sacco dhe banues në Milano, Itali, identifikuar me Pasaportën me nr. YB1219989, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **"C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në datën 13.09.2018, me NUIS: L 82113026 P;

BLERËSI:

- **z. Halim Saliu**, i datëlindjes 05.08.1978, lindur dhe banues në Skuterre, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftimin nr. 030839257 dhe nr. personal: H80805213T;

NENI 1

Shitësi është ortak me 100% të kuotave të shoqërisë "C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 13.09.2018, me NUIS: L 82113026 P, me seli në, QTZHK, Pallati i Kulturës, kati i II, Zyra nr. 17, Tiranë.

- 1.1 Këto kuota të shoqërisë Shitësi ia shet Blerësit i cili pranon t'i blejë ato sipas kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

NENI 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës në pronësi të Shitësit, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k., është në vlerën nominale prej 1.000 Lek.

NENI 3

- 3.1 Blerësi, i blen kuotat që shet Shitësi, si më poshtë:

Halim Saliu, blen 1 (një) kuotë, dhe bëhet ortak me 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k.

- 3.2 Me shitjen e këtyre kuotave, përbërja e ortakëve në shoqërinë "C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k. ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Halim Saliu

zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 3.3 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "C.G.F. COSTRUZIONI GENERALI" Sh.p.k., Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja, përfshirë të gjitha të drejtat dhe detyrimet kundrejt palëve të treta, nënkontraktorëve dhe shtetit.

NENI 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme; ai e shet këtë kuotë të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi të nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën.

NENI 5

- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë pa vërejtje.

PALET KONTRAKTORE

Martina Lorenzetto

Halim Saliu

Ortakia znj. Martina Lorenzetto, shtetase italian, mori dëjani për përmbajtjen e kësaj Kontrate shitblerje Kuotash nga përkthimi i bërë në gjuhën Italiane nga z. Anteo Papa.